



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 124/2011**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi për ankesën e Rüştû Taç në cilësinë kandidatit për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Kosova Türk Birliği (KTB), paraqitur për shkak të parregullsive gjatë procesit të numërimit të votave, në seancën e panelit të mbajtur me 02.02.2011, mori këtë:

## **V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e Rüştû Taç në cilësinë kandidatit për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Kosova Türk Birliği (KTB).

## **A r s y e t i m**

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 31.01.2011, nga Rüştû Taç në cilësinë kandidatit për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik KTB, me të cilën pretendohet se:

- Sipas rezultateve preliminare të KQZ-së që janë shpallë mbas zgjedhjeve, numri i votave për KTB ka qenë 1836 vota, me datë 30.01.2011 del pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja del se KTB i ka 1364 vota, subjekti i politik KTB mendon se votat i kanë kaluar në ndonjë subjekt tjetër politik;
- Dy vende të rezervuara në Kuvendin e Kosovës janë ndarë vetëm një (1) subjekti politik – KDTP. Parashtruesi i ankesës mendon se vendet e rezervuara për subjektet politike turke dy (2) është dashur të ndahen nga një (1) secilit subjekt politik;
- Parashtruesi i ankesës konsideron se janë shkelur të drejtat e subjektit politik KTB nga ana e faktorit vendimmarrës për këtë çështje dhe kërkon nga PZAP-i kërkon të përmirësoj këtë padrejtësi po ashtu subjekti politik KTB kërkon që dy (2) vendet e rezervuar të japin këtij subjekti politik.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

*(c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

- **ankesa është e pabazuar.**

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës PZAP-i i konstaton se janë të pabazuara, për arsye se i njëjti ankesës nuk i ka bashkangjitur asnjë provë t vetme materiale dhe nuk ka dhënë asnjë udhëzim se ku mund të bazohen shkeljet e pretenduara, në atë mënyrë që të mund të vërtetohet gjendja faktike siç pretendohet në ankesë. Në mungesë të provave apo fakteve PZAP-i ankesën si të tillë në tërësi e refuzoi si të pabazuar.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 124/2011 më datën 02.02.2011

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**

